

LEXMARK
LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU
DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron
asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Çështje azili
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Apeli kundër dëbimit
- Shtetësi britanike

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe
transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME
VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët
që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488



Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF



www.lexmarklegal.com

The **Albanian**

VITI I 23 I BOTIMIT 10 MARS 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

TABLOIDËT BRITANIKË, INTERES OBSESIV PËR BANDAT KRIMINALE SHQIPTARE



PETRIT KUÇANA

DERI KUR?!



ARBEN MANAJ

KTHESA E STARMER PËR LUFTËN NË IRAN, POR TRUMP THOTË SE NUK I NEVOJITET

KUR VUÇIÇI IZOLOHET, RAMA GATI
T'I DALË NË NDIHMË
(MADJE EDHE NË DËM TË
KOSOVËS)

ENVER ROBELLI




TUNDIMI I NJË
ALEANCE
TË RREZIKSHME

SONILA MEÇO




ABDIKIMI I ANTARËVE
EDHE RRËNIMI I PARTISË
SOCIALISTE

IRENA BEQIRI



CEREMONIA PËR BALLUKUN,
PSIKOZA E NDERIMIT
TË HAJDUTËVE

ANDI BUSHATI



RRËFIME
PAQEJE

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Si duhma e zezë e folklorit, ngjan pafundshmëria e kronikave të zeza për shqiptarët e Britanisë.

Do të mjaftojë një 'abonim' në masmedian online dhe gjendesh përballa katrahurës së pafundme të bëmave, bashkë me fotot e të rinjëve shqiptarë.

Nuk janë thjesht dhe vetëm media 'gjahkërkuese', (kur elementi shqiptar mbetet tejet i preferuar), por thujse nuk ka më dallim asnjë.

Siku të mos mjaftonte deklarata e ministres laburiste për 700 familjet shqiptare, që u paska mbaruar çdo kërkesë për azil, 'elementi shqiptar' vazhdon të mbetet mjerisht, në shumë e shumë raste, dominues në kronikat e zeza.

Duken të pafundme kronikat e shoqëruara me foton/fotot e shqiptarëve, ku përshkruhen edhe bëmat e tyre, shumtë e parave, aktivitetin kriminal...

Është thujse e vështirë, të ndalësh e të mendosh, se çfarë ndodhi me ne si shqiptarë?

Përse-ja është munduese në çdo kronikë të zezë që ndjek, pas çdo fotoje, pas çdo raportimi...

'Zemreku (lexo kurdisja), duket se

është kurdisur kohë më parë, atëherë kur në mëmëdhe u legalizua e keqja, e kur shoqëria heshti, e pranoi...

Ja një dekadë prej asaj kohe ,ndjehen pasojat edhe këtej në Britaninë e Madhe. E mbase tek ky zemrek, e kanë përgjigjet edhe pyetjet se përse asnjë shqiptar i Kosovës ,nuk është i përfshirë, përse asnjë nga Maqedonia, nga Mali i Zi... nga dreqi I mallkuar...

E përse-ja vazhdon e vazhdon të jetë bashkëudhëtare, thujse çdo ditë, në çdo kronikë, e madjemajde në masmedian shqiptarë është kthyer në një lloj normaliteti, e mbase-mbase trend.

DERI KUR?



E vetma pyetje që duket që mund të jetë plotpërbushëse si shpëtim mbetet; Deri kur?

Sa kohë do i duhet asaj shoqërie për të ripërcaktuar systemin e vlerave? ribotim

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



The Albanian

L E X M A R K
L E G A L

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apeline dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.

Ekspertë të besuar të imigracionit.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488



Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF



ARBEN MANAJ

E ndersa konflikti ne Lindjen e Mesme vazhdon, Ministria e Jashtme britanike thote se Starmer po nxjerr mesime nga ajo qe nuk shkoj ne luften ne Irak para dy dekadash, pas kritikese se Toni Blerit per qasjen e Britanise ndaj luftes amerikano-izraelite ne Iran.

Sakaq, edhe pse Britania shpreh gatishmerine per dergimin e nje aeroplanmbajtese te saj ne rajon, Trump thote se ajo s'na nevojitet kur luften po e fitojme.

Por, a eshte prishur ura mes Londres dhe Uashingtonit, kaq e rendesishme per shume sfida gjeopolitike ne epoken e Trampit?

E ndersa hidhen raketa mes palëve në konfliktin në Iran, shigjeta, ende edhe këtë fundjavë, po shkëmbehen edhe mes Londrës dhe Uashingtonit, nga mosgatishmëria e Starmër për të lejuar fillimisht bazat ushtarake britanike për operacionet amerikane të luftës dhe bombarduesit e rëndë strategjik amerikan, çka edhe këtë të djelë po ulen e ngrihen nga baza Fairford ne Angli .

Është e qartë gjithësesi se Trump ndihet i lënduar dhe i mavjosur nga goditjet e një aleati të vjetër, më të madhit të Amerikës, në fakt historikisht, si Britania e cila sipas presidentit

KTHESA E STARMER PËR LUFTËN NË IRAN, POR TRUMP THOTË SE NUK I NEVOJITET

amerikan, i cili i ktheu shpinën në orën e nevojës së saj për mbështetje.

Pa pikën e dyshimit, marrëdhëniet speciale mes Uashingtonit dhe Londrës, kanë nevojë për riparime nga dëmtimet që i ka sjell lufta në Iran, ku legaliteti i këtij konflikti mbetet një pikë e kontestueshme.

(Kur shumica e amerikanëve janë kundër luftës, Trumpi ka nevojë për kapital politik dhe në këto rrethana ka nevojë për vlerësimin dhe mbështetjen nga aleatët. Britania nuk është i vetmi vënd kundër Trampit, në këtë aventurë, por është kapur me Starmër dhe po e përdor marrëdhënien e vecantë me Britaninë për një trajtim të vecantë.)

Në mbështetje të Trump është shfaqur ish-kryeministri i majtë laburist Toni Bler i cili mbështeti amerikanët si cdo paraardhës i tij në cdo gjë që kanë bërë amerikanët nga krijimi i saj si superfuqi botërore, aq më tepër në Irak para dy dekadës kundër Irani luftonte me Irakun. Për Starmër dhe administratën e tij, përfshirja britanike në atë botë mbetet një njollë e zezë në politikën britanike,

andaj Ministria e tij e Jashtme thotë se Starmër po nxjerr mesime nga ai konflikt për c'ka nuk shkoj mirë dhe indirekt njeriu nga i cili nuk kërkohen mënd, është Toni Bler, tashme një nga njerëzit e afërt të Trump në Bordin e Paqes dhe rindërtimin e Gazës.

(Starmër në qëndrimin e tij për fatin e tij ose jo, ka përballë dy nga politikanët që urrehen thuajse njësoj në opinionin vendas, Trump dhe Blair).

Por ajo që po mungon në narrativën politike është mosshpjegimi i qarte dhe pa ekuivok i administratës britanike se cilat janë përkishtë ato interese kombëtare britanike që po mbron më shumë Starmër.

Kritikët e tij, thone së qëndrimi i Starmër lidhet më shumë me mbijetesën e tij politike në vënd, sesa me interesat strategjike britanike apo më gjerë të Evropës me një konflikt tjetër të pambyllur si ai në Ukrainë, ku amerikanët janë kritikë në shuarjen e tij.

Irelevanca politike e një njeriu si Starmer që është pare si ndërtuesi ose



roja e urrës mes dy anëve të Atlantikut i cili po tregon muskujt, në një epokë të paparashikueshme si ajo e Presidentit Tramp, është argumentueshëm akoma më shqtesuese kur Amerika thotë se nuk e harrojmë këtë thikë pas

shpine nga Britania, e drejtuar nga një kryeministër laburist, si asnjë kryeministër i mëparshëm, i maljte apo i djathte në vëndin e vogël gjeografikisht, aleat i madh i nje superfuqie të rilindur.

DEPUTETËT NISËN NJË HETIM PËR KREDITË STUDENTORE

Një hetim mbi kreditë studentore po nisët nga deputetët mes "pakënaqësisë së përhapur" mbi kushtet e ripagimit.

Komiteti i Thesarit do të shqyrtojë nëse vendimi i fundit për të ngrirë pragun e ripagimit për shumë të diplomuar në Angli është i drejtë.

Hetimi do të shqyrtojë gjithashtu nëse kushtet e ripagimit janë "të arsyeshme" kur merren në konsideratë së bashku me "taksimin më të gjerë të të diplomuarve", siç është tatimi mbi të ardhurat.

Departamenti i Arsimit (DfE) tha se ngrirjet kishin për qëllim "mbrojtjen e taksapaguesve dhe studentëve".

Hetimi do të shqyrtojë të gjitha planet e kredive studentore, por polemika e fundit ka rrethuar kreditë e Planit 2, të cilat u lëshuan në Angli midis shtatorit 2012 dhe korrikut 2023 dhe ende lëshohen në Uells.

Të diplomuarit me kredi të Planit 2 paguajnë 9% të gjithçkaje që fitojnë mbi pragun e ripagimit. Kancelarja Rachel Reeves njoftoi në buxhetin e nëntorit se pragu do të ngrihej në 29,385 £ midis viteve 2027 dhe 2030, në vend që të rritej me inflacionin. Kjo do të thotë që të diplomuarit do të fillojnë të shlyejnë kreditë më shpejt dhe ata që fitojnë mbi pragun do të shohin një pjesë më të madhe të pagës së tyre të nënshtruar ndaj shlyerjes së kredive studentore sesa do të kishin bërë vetë.

Aktivistët kanë bërë thirrje që ngrirjet të anulohen, si dhe për një normë më të ulët shlyerjeje dhe një normë in-



teresi më të ulët – e cila aktualisht është masa e Indeksit të Çmimeve me Pakicë (RPI) e inflacionit për të diplomuarit plus deri në 3% në varësi të të ardhurave.

Dame Meg Hillier, kryetare e Komitetit të Thesarit, tha se shumë njerëz kishin përfutur nga aksesi i zgjeruar në arsimitin e lartë përmes sistemit të kredive studentore, por hetimi do të pyeste nëse "shtyllat e portës janë zhvendosur në një mënyrë që është e padrejtë për të diplomuarit". "Normat e interesit në rritje dhe ndonjëherë normat marxhinale të taksave veçanërisht të larta kanë çuar qartë në pakënaqësi të përhapur midis të diplomuarve të cilët mund të mos i kenë kuptuar plotësisht kushtet e tyre të

shlyerjes dhe mundësinë që ato mund të ndryshojnë", tha ajo.

Natalie Whittaker, 27 vjeç, nuk pendohet që ka shkuar në universitet, por mendon se nuk ishte "informuar siç duhet" për pasojat financiare të marrjes së një kredie të Planit 2.

Një grua e veshur me një pulovër të thurur ngjyrë jeshile të errët është ulur brenda. Ajo ka flokë të drejtë ngjyrë kafë me gjatësi mesatare dhe skaje më të çelëta. Në sfond, një llambë e rumbullakët e ngrohtë ndriçon pranë një bime me gjethë. Një dritare me perde horizontale është e dukshme në të majtë dhe një pasqyrë me kornizë varet në mur në të djathtë.

Diplomuarja Natalie tha se pagesat u krahasuan me "çmimin e një kafeje".

Ajo filloi një diplomë në prodhimin e medias në Universitetin e Salfordit në vitin 2016 dhe një master në Universitetin e Liverpoolit tre vjet më vonë. Interesi do të thotë që, pavarësisht pagesave, borxhi i saj prej 52,000 £ pas largimit nga universiteti është rritur që atëherë në rreth 75,000 £.

"Na thanë se nuk është borxh i vërtetë, ose është thjesht çmimi i një kafeje, ose se nuk do ta vini re fare që del nga paga juaj", tha ajo.

"Por tani jemi në moshën kur po fitojmë mjaftueshëm për të filluar pagesat dhe po mendojmë, 'prit një minutë, ky nuk është çmimi i një kafeje'."

Hetimi vjen pasi BBC zbuloi se qeveria krahasoi pagesat e kredive studentore me një kontratë telefonike prej 30 paundësh në muaj në një prezantim për adoleshentët një dekadë më parë, dhe prezantuesve iu kërkua të mos e përdornin fjalën "borxh".

Të mërkurën, Sir Nick Clegg, ish-lidheri i Liberal Demokratëve, i tha BBC-së se sistemi aktual i tarifave të shkollimit universitar ishte një "rrëmujë".

Analiza e BBC-së ka zbuluar se shumica e parave që të diplomuarit po paguajnë vullnetarisht për të shlyer borxhin e tyre është rritur, ndërsa disa të diplomuar na thanë se kombinimi i

shlyerjes së kredisë dhe tatimit mbi të ardhurat i ka çuar ata të ulin pagat e tyre.

DfE tha se kishte trashëguar një sistem kredish studentore "të hartuar nga qeveria e mëparshme" dhe ngrirjet ishin aty për të "mbrojtur taksapaguesit dhe studentët".

Ai tha se sistemi "mbron të diplomuarit me të ardhura më të ulëta" me ripagime të lidhura me të ardhurat dhe bilance që shlyhen pas një periudhe të caktuar kohore.

Të mërkurën, Reeves u tha deputetëve se ekzistonte një "hierarki prioritetesh".

"E pranoj që kemi trashëguar një sistem të prishur kur bëhet fjalë për financimin e studentëve, ashtu siç kemi trashëguar një NHS të prishur, një sistem burgjesh dhe shumë më tepër", tha ajo.

Unioni Kombëtar i Studentëve tha se ishte "gati të shfrytëzonte këtë mundësi për të punuar së bashku për të rregulluar kreditë studentore".

Komiteti po fton këdo mbi moshën 16 vjeç të ndajë përvojat e tij me sistemin nëpërmjet një ankete online. Komiteti do të shqyrtojë sistemin në Angli, por do të mirëpresë edhe propozime nga pjesë të tjera të Mbretërisë së Bashkuar.

medipark

DAY HOSPITAL

Klinika jonë ofron shërbime mjekësore të avancuara, me staf profesionist dhe pajisje moderne për kujdes të sigurt dhe të shpejtë.

- Kontrolle të Përgjithshme Shëndetësore
- Kujdes Emergjent dhe Urgjent
- Kardiologji dhe Shëndet Zemre
- Pediatri dhe Mjekësi Familjare
- Ortopedi dhe Fizioterapi
- Imazheri Diagnostike dhe Analiza Laboratorike

**20%
OFF**

**zbritje në çdo
paketë kontrolli
mjekësor.**

📄 Konsulta mjekësore 🧪 Analiza laboratorike 🕒 Kontroll rutinë 📞 Vizita dhe trajtime të menjëhershme



573–575 Green Lanes, Harringay Ladder, London N8 ORL
0208 341 3185 – 07947 785174

SONILA MEÇO

TUNDIMI I NJË ALEANCE TË RREZIKSHME

Trishtimi më i madh është se as Kosovën nuk e la të qetë.

Se edhe në atë shtet të ri, të pavarur, të ushtruar nga reflekse patriotizmi prej vuajtjes e gjenocidit do të guxonte të bënte arkitektin e prapaskenës, sa me shkëmbime terriroresh, sa me Open Balkan, marrëveshje me Vučić, refuzimin e rezolutës kundër genocidit serb, ambicje udhëheqësie rajonale, apo lobime veç për shah intrigash në skakierën politike të saj dhe jo për njohje dhe integrim ndërkombëtar.

Të zgjedhësh si aleat në rrugëtimin politik Ramën, duke ia njohur filozofinë qeverisëse, pasionin për autokracinë, mjeshtërinë e kulisave nga me diaboliket, lobuesit, financuesit, (anti)modelin ekonomik ku e zhyti Shqipërinë, shkatërrimin e institucionit të zgjedhjeve të lira, imazhin ndërkombëtar si drejtues me liçensë i një narkoshteti...pra me vetëdije të zgjedhësh të ushqesh ambicien politike nga kjo "çorbë" e prishur interesash mbi vuajtjet e shqiptarëve, këndej e andej vargjeve malore të Sharrit dëshmon pragmatizëm vetës-abotues.

Mjafton të vëzhgosh se ku e si kanë përfunduar "aleatët" e tij në vite. Me të cilët ndau interesa edhe më të ngushta se nevoja akute për kontroll të ekuilibrave edhe në një moment politik në Kosovë.

Institucioni i presidentit të Kosovës



nuk mund të konkurrojnë në marrëdhëniet personale dhe rivalitetin e liderëve rajonalë. Ai është simboli i sovranitetit të shtetit.

Për këtë arsye, çdo situatë ku krijohet përshtypja se politika e brendshme e

Kosovës mund të bëhet pjesë e strategjive rajonale të një lideri tjetër, dëmton jo vetëm ekuilibrat politikë të Prishtinës, por edhe perceptimin ndërkombëtar për pavarësinë e vendimmarrjes së saj, dëmton mu bash atë që Kosova ka mbrojtur me

dekada, pavarësinë e plotë të vendimmarrjes së saj politike.

Një presidente që ka ndërtuar autoritetin e saj politik mbi idenë e sovranitetit të pakompromis të vendit duhet të jetë po aq e para në ruajtjen

e distancës nga çdo strategji që e trahet politikën e Prishtinës si hapësirë manovrimi rajonal.

Në momentin që kjo distancë zbehet, edhe pa dashje krijohet një paradoks i rrezikshëm politik.

Përpjekja për të konsoliduar një pozicion të fortë të brendshëm mund të përfundojë duke e lidhur atë me një lojë që nuk është projektuar në Prishtinë. Deja Vu!

Historia politike e një mirë këtë mekanizëm. Ambicia shpesh e bind një figurë publike se mund të përdorë një lojtar më cinik për një fitore taktike.

Por në fund, në më të shumtën e herëve ndodh e kundërta, lojtari më cinik merr frytet, ndërsa tjetri flaket si servis njëpërdorimësh.

Do të qe keqardhje e madhe fitorja e një autokrati me eksportin e pamëshirshëm të mekanizmave që degradojnë elitën e Kosovës, kur i vetmi sukses rajonal është importi i qumështit dhe garancia për pushtet nga Beogradi.

Mos na zhgënjë të paktën ti Kosovë!

Dotech

website 

“ AKOMA NUK KENI
NJË WEBSITE PËR
BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



**FOR SALE
PËR SHITJE
TEL:07393 417716**



BIZNES PER SHITJE

**Biznes per shitje ne Oakwood
North London N14
10 years lease
Per me shume info
Tel:07393 417716**



MARCUS TANNER

Ka qaq shumë gjëra që po digjen tani – nga instalimet qeveritare dhe ushtarake në Iran te hotelet luksoze, konsullatat amerikane dhe pusët e naftës në Gjirin Persik – dhe, këtu në Britani, edhe Partia jonë në pushtet, Laburiste.

Në filmin klasik të vitit 1974 ‘The Towering Inferno’, një grup mysafirësh guximtarë vrapojnë poshtë boshitit të ashensorit për t’u shpëtuar flakëve që përfshijnë një ndërtesë të lartë, ndërsa ajo shembet në një grumbull të shkrirë si llavë.

Një version i këtij filmi katastrofik duket se po zhvillohet brenda Partisë Laburiste, ku një stuhia politike po shpërthen – e nxitur pjesërisht nga një zgjedhje e pjesshme e fundit në Mançester – duke bërë që disa deputetë të shqetësuar të mendojnë për arratisje drejt një dere daljeje të shënuar “Green”.

Për ta përmbledhur: një zonë që më parë ishte një bastion i hekurt i Laburistëve – një vend ku votuesit dikur thoshin se “do të votonin edhe për një qen nëse do të ishte kandidati i Laburistëve” – ra me një humbje dërmuese në duart e Partisë së Gjellbër, një forcë populiste e majtë në rritje.

Laburistët jo vetëm që humbën këtë votim simbolik; ata ranë në mënyrë poshtëruese në vendin e tretë, pas partisë së ekstremit të djathtë Reform.

Të gjithë sytë tani janë te zgjedhjet vendore të majit, ku pritet pothuajse me siguri një disfatë e rëndë për Laburistët, ndërsa si të Gjellbrit ashtu edhe Reform mund të bëjnë hapa të mëdhenj përpara, gjë që mund të nxisë një sfidë për udhëheqjen e kryeministrit Keir Starmer.

A do ta shmangë një grusht shteti i minutës së fundit brenda partisë së përçarë kolapsin e saj? Ende nuk dihet.

Ndërsa një luftë civile politike përfshin të majtën, zemërimi dhe frustrimi përfshin të djathtën. Partia Reform ishte mjaft e sigurt për fitore në zgjedhjen e fundit të pjesshme – derisa votues myslimanë të brezit të dytë, kryesisht me origjinë pakistaneze, e shkatërruan atë plan duke votuar në bllok për të Gjellbrit.

Tani Reform përballet me një skenar makthi: votues myslimanë me prejardhje migrante që votojnë së bashku me të ashtuquajturit “progresistë urbanë” nën flamurin e të Gjellbërve në zgjedhjet vendore dhe në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme, kryesisht për të mbajtur Reform jashtë pushtetit.

Tabloidët e djathtë kanë shpërthyer në zemërim, duke fajësuar humbjen për mashtrim elektoral me “votim familjar” (pra burra që shoqërojnë në

TABLOIDËT BRITANIKË, INTERES OBSESIV PËR BANDAT KRIMINALE SHQIPTARE



mënyrë të paligjshme gratë në kabinat e votimit) dhe për “votues të huaj” – që në thelb duket se do të thotë myslimanë. Udhëheqësi i Reform, Nigel Farage, ka kërkuar ndalimin e këtyre votuesve “të huaj”, një thirrje e përqaftuar menjëherë nga media mbështetëse si ‘Daily Mail’.

Të shkretët lexues të ‘Daily Mail’! Çdo mëngjes duhet të përballen me qaq shumë armiq – nga myslimanët të “tradhtari” Starmer, studentët e majtë, aktivistët pro-Palestinës, progresistët urbanë dhe “parazitët” e ndihmës sociale – lista vetëm sa zgjatet.

Por gjithmonë ka vend për më shumë armiq në botën e tabloideve britanike – veçanërisht nga pjesa e tyre më pak e preferuar e Evropës, Ballkani.

Ata kanë prej kohësh një interes obsesiv për bandat kriminale ballkanike që bëjnë kërdinë në Britani, veçanërisht ato nga Shqipëria.

Megjithatë, së fundmi ‘Daily Mail’ zbuloi një markë të re intriguese kriminelësh ballkanikë – hajdutë çokollate.

“Bandat e pamëshirshme kriminale rumune janë pas një epidemie vjedhesh të çokollatës nga dyqanet e rrugëve kryesore britanike,” shpallte një titull që për arsye të paqarta lidhi bandat rumune me vjedhjen misterioze të 200 mijë vezëve të çokollatës ‘Cadbury Crème Egg’, mes produkteve të tjera.

“Hetimet e ‘Daily Mail’ kanë zbuluar

lidhje mes vjedhjes së çokollatës dhe bandave të krimit të organizuar që veprojnë në Britani dhe në Evropën Lindore, veçanërisht në Rumani,” raportonte gazeta – pa dhënë shumë detaje konkrete. Artikulli shoqërohej me një foto të një çokollate të madhe ‘Cadbury’s Dairy Milk Oreo’ – me sa duket pikërisht ajo që këta hajdutë ballkanikë kërkojnë.

Pse kriminelët rumunë do të vinin nga Bukureshti në Londër vetëm për të vjedhur çokollatë mbetet një pyetje. Në fund të fundit janë çokollata, jo ar. Ndoshta rumunët nuk i rezistojnë dot shijes së ‘Cadbury’.

Megjithatë ‘Daily Mail’ ka ndjenja të përziera për Rumaninë. Shpesh promovon pronat rurale të Mbretit Charles në Transilvani dhe këtë javë e përshkroi kryeqytetin Bukuresht si një “Paris i vogël”, të njohur për “sharm mesjetar” – çka është e çuditshme, pasi Bukureshti ka shumë pak ndërtesa mesjetare. Ndoshta e ngatërruan me Pragën.

Kontrabandistët e cigareve në TikTok

Kriminelët shqiptarë që bëjnë kërdinë në Britani janë një temë shumë më e njohur për tabloidët. Javën e kaluar mësuam, sërish nga ‘Daily Mail’, se “bandat shqiptare po e përmbysin Britaninë me cigare ilegale”.

“Një hetim i ‘Daily Mail’ gjeti shumë faqe në TikTok dhe Facebook në gjuhën shqipe që ofrojnë cigare nga

marka të mëdha si Marlboro për klientët në Britani,” raportoi gazeta. Dhe, në rast se e kishim harruar, na kujtoi gjithashtu se “grupet shqiptare tashmë kontrollojnë pjesën më të madhe të tregut të kokainës në Britani”.

Këta gangsterë thuhet se shesin cigare përmes Facebook, TikTok dhe Instagram, duke ofruar marka që zakonisht shiten për 17 paund në dyqanet britanike vetëm për gjashtë ose shtatë paund.

Rritja e madhe e taksave të duhanit në vitet e fundit, e synuar për t’i larguar njerëzit nga pirja e duhanit, ka krijuar gjithashtu një treg të madh të zi për cigare ilegale në Britani. Megjithatë burime policore thonë se lojtarët më të mëdhenj në këtë treg janë kurdë dhe kinezë, jo shqiptarë.

Edhe ‘Daily Express’, rivali më i vogël por po aq i zhurmshëm i ‘Daily Mail’, pëlqen t’u kujtojë lexuesve skandale që përfshijnë kriminelë shqiptarë. “Krimineli shqiptar i deportuar dy herë feston 10 vjet në Britani me një festë shampanje”, raportoi së fundmi.

“Një kriminel shqiptar i karrierës punësoi valltare burleske për një festë të mbushur me shampanjë për të festuar 10 vjet qëndrimi në Britani pavarësisht se ishte urdhëruar të largohej”, raportoi *Express*, për Dorian Pukën, 29 vjeç, i cili ka kryer dy dënime me burg në Britani për grabitje dhe është deportuar dy herë, vetëm për t’u futur sërish kontra-

bandë.

Mesazhe të përziera për Shqipërinë

Historitë e tabloideve për kriminalitetin shqiptar shpesh gjejnë jehonë edhe në gazetën më serioze por po aq të djathtë ‘Telegraph’, e cila së fundmi raportoi se shqiptarët që punojnë ilegalisht në Britani po marrin udhëzime në TikTok nga shqiptarë të tjerë se si të shmangin kontrollet e policisë.

“Shqiptarët po përdorin TikTok për t’u treguar punëtorëve ilegalë si të pengojnë kontrollet e Home Office në biznese,” raportoi gazeta.

Në realitet, megjithatë – larg botës së tabloideve – qeveria britanike është relativisht efikase në deportimin e kriminelëve shqiptarë, thjesht sepse kjo është relativisht e lehtë sipas marrëveshjeve ekzistuese me Tiranën.

Sipas Home Office në shkurt, “shtetasit shqiptarë përbënin një të katërtën (2,440) e të gjitha kthimeve të detyruara në 12 muajt e fundit.

Numri i kthimeve të detyruara të shtetasve shqiptarë u rrit pas nënshkrimit të Komunikatës së Përbashkët MB-Shqipëri në dhjetor 2022, e cila ishte një përgjigje ndaj numrit të madh të mbërritjeve të shqiptarëve me varka të vogla në vitin 2022”.

Dhe jo të gjitha mediat britanike e kanë gjithmonë me shqiptarët. Ka edhe përshkrime shumë më pozitive në rubrikat e turizmit dhe faqet e udhëtimeve, disa prej të cilave po e promovojnë Shqipërinë si “Kroacia e re”.

Saga Holidays, që synon kryesisht turistë të moshuar, e renditi Shqipërinë së fundmi në vendin e katërt mes “shtatë destinacioneve që duhen vizituar në 2026”.

“Vendet kryesore përfshijnë plazhet dhe ujërat bruz të Ksamilit (që mund të vizitohen me traget nga Korfuzi); Beratin, i njohur si ‘Qyteti i një mijë dritareve’ për arkitekturën e tij osmane dhe shqiptare; dhe kryeqytetin, Tiranën,” shkruante Saga.

Megjithatë, duke pasur parasysh ndjenjën e përgjithshme britanike të rënies së ngadaltë dhe varfërimit, kostoja ishte natyrisht një faktor kryesor. “Shqipëria është aktualisht një nga vendet më të lira në Evropë.

Vizitoheni për akomodim, ushqim dhe transport të përbalueshëm,” theksonte Saga.

Marrë nga BalkanInsight

FOR SALE

BM TRANSPORT MALLRASH ËSHTË PËR SHITJE

FOR SALE

**LINJA E TRANSPORTIT
ANGLI-SHQIPERI-ANGLI
QË OPERON PREJ
MË SHUMË SE 6 VITE
ËSHTË PËR SHITJE**

**BIZNESI SHITET BASHKË
ME TRE FURGONAT**



**07713 888454
00355 6869 02123
00355 6857 19175**



**ME KLIENTELË
TË GARANTUAR**

STARMER DHE TRUMP FLASIN PËR HERË TË PARË QË NGA KRITIKAT E PRESIDENTIT NDAJ IRANIT

Sir Keir Starmer dhe Donald Trump kanë folur për herë të parë që kur presidenti amerikan kritikoi me zemërim përgjigjen e Mbretërisë së Bashkuar ndaj Iranit.

Nr. 10 publikoi detaje të kufizuara të thirrjes, duke thënë se të dy udhëheqësit diskutuan situatën në Lindjen e Mesme dhe bashkëpunimin ushtarak midis Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-së.

Të shtunën, presidenti tha se Mbretëria e Bashkuar po shqyrtonte dërgimin e transportuesve të avionëve në Lindjen e Mesme, por e hodhi poshtë këtë mundësi, duke shkruar në mediat sociale “nuk kemi nevojë për njerëz që bashkohen me Luftërat pasi kemi fituar tashmë!” – ndërsa e etiketoi Britaninë “aleatin tonë dikur të madh”.

Sir Keir ka thënë më parë se Mbretëria e Bashkuar nuk do t’u bashkohet veprimeve ofensive, por ka rënë dakord të lejojë SHBA-në të përdorë bazat britanike për sulme mbrojtëse në vendet e raketave iraniane.

Trump ka shprehur vazhdimisht zhgënjimin e tij ndaj kryeministrit, pasi ai refuzoi një kërkesë të SHBA-së për të përdorur bazat e Mbretërisë së Bashkuar për sulmet fillestare ofensive kundër Iranit.

Më herët këtë javë, Trump tha se “nuk ishte i kënaqur me Mbretërinë e Bashkuar”, duke shtuar se Sir Keir “nuk ishte Winston Churchill”.

Duke folur për të Sunday me Laura Kuenssberg, Sekretarja e Jashtme Yvette Cooper tha se Sir Keir Starmer kishte “të drejtë që mbron interesat e Britanisë” dhe se qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nuk do të pajtohej me presidentin “për çdo çështje”.

“Është detyrë e presidentit të SHBA-së të vendosë se çfarë mendon se është në interesin kombëtar të SHBA-së, dhe kjo është detyrë e tij.

“Por është puna jonë si qeveri e Mbretërisë së Bashkuar të vendosim se çfarë është në interesin kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar, dhe kjo nuk do të thotë thjesht të biem dakord me vendet e tjera ose t’ia delegojmë politikën tonë të jashtme vendeve të tjera.”

Yvette Cooper: ‘Mbretëria e Bashkuar nuk pajtohet me Trumpin për çdo çështje’

Pas telefonatës midis Trump dhe Sir Keir, Downing Street tha në një deklaratë: “Udhëheqësit filluan duke diskutuar situatën e fundit në Lindjen e Mesme dhe bashkëpunimin ushtarak midis Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-së përmes përdorimit të bazave të RAF në mbështetje të vetëmbrojtjes kolektive të partnerëve në rajon.”

“Kryeministri gjithashtu ndau



ngushëllimet e tij të sinqerta me Presidentin Trump dhe popullin amerikan pas vdekjes së gjashtë ushtarëve amerikanë.

“Ata mezi prisnin të flisnin përsëri së shpejti.”

Pavarësisht kritikave nga Trump, Downing Street ka mbrojtur vendimin e saj për të mos u bashkuar me sulmet fillestare dhe ka përsëritur se nuk dëshiron të marrë pjesë në fushatën më të gjerë ofensive në Lindjen e Mesme.

Cooper tha se Mbretëria e Bashkuar do të “ofrojë mbështetje mbrojtëse kur të shohim sulme iraniane në vendet partnere ku banojnë qytetarë britanikë”.

Avionë luftarakë të RAF-it janë dërguar në rajon për të rrëzuar raketat dhe dronët e qëlluar nga Irani drejt aleatëve të Mbretërisë së Bashkuar.

Aeroplanmbajtësja britanike HMS Prince of Wales është vendosur në gatishmëri të avancuar, por sekretari i jashtëm nuk konfirmoi nëse ajo do të dërgohet në rajon.

Të premtën, ish-kryeministri laburist, Sir Tony Blair – i cili udhëhoqi Mbretërinë e Bashkuar në luftën e Irakut në vitin 2003 – tha në një aktivitet privat se Mbretëria e Bashkuar duhet t’i kishte mbështetur sulmet që nga fillimi.

Ai tha se SHBA-të ishin një “gur themeli i domosdoshëm” i sigurisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe se aleatët duhet të “shfaqen” pavarësisht se kush është presidenti aktual.

Cooper, i cili ishte ministër i ri në qeverinë e Sir Tony-t kur Mbretëria e Bashkuar iu bashkuar pushtimit amerikan të Irakut, tha se ishte “e rëndësishme të nxirren mësim nga ajo që shkoi keq” në atë konflikt.

Ajo tha se kjo përfshinte “njohjen se të gjitha vendimet tona duhet të kenë të bëjnë me atë që është e drejtë për qytetarët britanikë”.

Sekretari i jashtëm tha se “ka disa njerëz në politikë që mendojnë se ne duhet të biem dakord pa diskutim me SHBA-në sido që të jetë”, ndërsa të tjerë “mendojnë se nuk duhet të biem dakord kurrë me SHBA-në” ose “të pajtohemi me veprime të përbashkëta”, por asnjëra nuk ishte qasja e duhur.

Duke u shfaqur në të njëjtin program, ambasadori iranian në Londër e paralajmëroi Mbretërinë e Bashkuar të ishte “shumë e kujdesshme” në lidhje me përfshirjen e mëtejshme në luftë.

Seyed Ali Mousavi tha se “nëse objektet, pronat ose bazat përdoren kundër kombit iranian”, ato do të konsiderohen “objektiva legjitime”.

Robert Jenrick i Reform UK tha se partia e tij nuk mendonte se Mbretëria e Bashkuar duhet të merrte pjesë në sulmet sulmuese me bombardime mbi Iranin, por argumentoi se qeveria duhet t’i kishte lejuar SHBA-të të përdornin bazat e Mbretërisë së Bashkuar “që nga fillimi”.

Ai i tha Kuenssberg se “lëkundja e kryeministrit ka dëmtuar ndjeshëm marrëdhëniet me SHBA-në”.

Duke folur për Sky News, sekretari konservator i brendshëm në hije, Chris Philp, akuzoi qeverinë për “shpërdorim detyrë” duke mos arritur të zhvendosë anije luftarake në Qipro ose në Lindjen e Mesme përpara konfliktit.

“Problemi është se ato anije, në këtë moment, nuk janë askund afër Qipros. Ato nuk janë askund afër Gjirit”, tha Philp.

“Ata janë të lidhur në portet në Portsmouth sepse Keir Starmer dhe qeveria laburiste nuk treguan asnjë largpamësi, edhe pse e dinin tre ose katër javë më parë se Amerika planifikonte këtë veprim kundër Iranit, ata nuk i zhvendosën ato anije në rajon.”

Më herët këtë javë, një dron i vogël goditi pistën në RAF Akrotiri, duke shkaktuar atë që Ministria e Mbrojtjes e quajti “dëme minimale”.

HMS Dragon – e cila ka aftësi mbro-

jtëse ajrore – është aktualisht në Portsmouth, por po dërgohet në Mesdhe për të forcuar sigurinë përreth bazës RAF në Akrotiri të Qipros. Nuk pritet të niset deri javën tjetër.

Ekupazhit të HMS Prince of Wales i është thënë se duhet të jetë gati për t’u nisur brenda pesë ditësh.


I pyetur nëse Mbretëria e Bashkuar kishte qenë e ngadaltë në reagimin ndaj konfliktit, Cooper tha se Mbretëria e Bashkuar kishte “paravendosur” avionë luftarakë në rajon së bashku me 400 personel shtesë.

Ajo tha se që nga fillimi i konfliktit, qeveria kishte vendosur avionë luftarakë shtesë kundër tajfunëve dhe helikopterë Wildcat.

Ndërkohë, udhëheqësi i Liberal Demokratëve, Sir Ed Davey, tha se një vizitë e planifikuar e Mbretit Charles në SHBA duhet të anulohet.

“Në një kohë kur Trump ka nisur një luftë të paligjshme që po shkatërron Lindjen e Mesme dhe po rrit faturat e energjisë për familjet britanike, është e qartë se kjo vizitë nuk duhet të ndodhë.

“Një vizitë shtetërore nga Mbreti ynë do të shihej si një tjetër sukses i madh diplomatik për Presidentin Trump, kështu që nuk duhet t’i jepet dikujt që fyen dhe dëmton vazhdimisht vendin tonë.”



IRENA BEQIRI

Më 23 mars 1933, brenda një dhome të ndriçuar dobët, ku ndihej aroma e ndenjor e tymit të purove, Ludwig Kaas po përpigjej ta bindte veten se po merrte vendimin e duhur. Kaas një prift katolik dhe udhëheqës i Partisë së Qendrës ndodhej në udhëkryq. Për disa vite, partia e tij ishte përpjekur të bllokonte ngritjen e Adolf Hitlerit. Por në vitin 1932, Nacional-Socialistët e Hitlerit u bënë forca më e madhe në

ABDIKIMI I ANTARËVE EDHE RRËNIMI I PARTISË SOCIALISTE

parlament dhe në janar 1933, Hitleri u bë kancelar. Ndërsa Hitleri përpigjej të konsolidonte pushtetin, Partia e Qendrës ishte pengesa e fundit që ai të mos vendoste në kontroll të plotë Gjermaninë.

Hitleri kishte prezantuar Aktin e Mundësimit, akt i cili do t'i lejonte atij dhe kabinetit të tij mundësinë për të sunduar nëpërmjet akteve normative, duke e çmontuar demokracinë në thelbin e saj. Vetëm nëse Partia e Qendrës do të rezistonte, mund të bllokohej miratimi i aktit. Kaas dhe kolegët e tij udhëheqës të Partisë së Qendrës debatuan për orë të tëra, të ndarë midis mbrojtjes së parimit dhe vetëmbrojtjes. Disa kërkuan rezistencë, duke paralajmëruar se pushteti i Hitlerit duhej të kontrollohej. Por shumica kishin frikë nga pasojat e sfidës. Të tjerë ende mbaheshin pas shpresës se duke bashkëpunuar me Hitlerin, ata mund

të ndikonin te Hitleri.

Në fund, Kaas e bindi veten se opioni i tij më i mirë ishte të bashkëpunonte brenda realitetit të ri, në mënyrë që të mos shtypej prej tij. "Ne duhet ta ruajmë shpirtin tonë, por një refuzim i Aktit të Mundësimit do të rezultojë në pasoja të pakëndshme për partinë tonë". U tha ai kolegëve të tij. Akti u miratua duke i hapur rrugën diktaturës së Hitlerit. Mbështetja për aktin nuk kishte asgjë strategjike. Ajo nuk i moderoi qëndrimet e Hitlerit, përkundrazi i dha atij kontroll të plotë.

Ky episod ilustron logjikën e rrezikshme të abdikimit ose besimit se, përballë një kërcënimi në rritje për demokracinë, dorëzimi është strategji, edhe bashkëpunimi me një autokrat është mbijetesë. Sa herë më jepet mundësia të flasësh me socialistët të vjetër apo të rinj, antarë apo ish antarë të kryesisë së kësaj partie, ndjej po e

njëjtën logjikë abdikimi. Po, anëtarët kryesorë të partisë socialiste kanë abdikuar, edhe kjo nuk ka ndodhur sot, por që në vitin 2005.

Demokracia brenda saj u gërrye ngadalë, në fillim nëpërmjet dorëzimit gradual të atyre që e kishin ndërtuar e duhet ta mbronin atë. Pas çdo lëshimi, që partia bënte karshi kryetarit autokrati bëhej më të guximshëm më i pushtetshëm, ndaj dhe sot përmbysja u duket të gjithëve më vështirë. Përgjigjet që socialistët i konsideruan edhe i konsiderojnë pragmatike, duke pritur, duke heshtur, duke arritur një marrëveshje, vetëm sa e inkurajuan kryetarin autokrat duke çuar situatën deri tek urdhëresat me xheste.

Rënia e partisë Socialiste nuk ishte e pashmangshme, pasi udhëheqësit politikë kryesorë kishin shumë mundësi për t'u kundërpërgjigjur. Por disa në 2005 besonin se vetëm me Ramën në krye mund ta mundnin

Berishën, disa se mund ta përdornin afërsinë me Ramën për të siguruar dominimin e tyre. Disa besonin se mund ta kontrollonin Ramën edhe pasi ta bëhej Kryeministër. Të gjithë gaboheshin.

Demokracia brenda partisë rrallë vdes në një moment të vetëm. Ajo shkatërron nëpërmjet abdikimit: racionalizimeve dhe kompromiseve. Partia Socialiste vdiq kur kur anëtarët me ndikim brenda saj mësuan ti thonë vetes se po të lëshojnë vetëm pak terren, do ishin më të sigurt apo se gjetja e një gjuhe të përbashkët me një përçarës është më praktike sesa të qëndrosh kundër tij.

Kryetari autokrat i cili sot i urdhëron as me fjalë por më geste " të mbyllin gojën" nuk triumfoi kurrë vetë. Ai pati sukses sepse të tjerët e mundësuan atë, për shkak të ambicies së tyre, për shkak të frikës së tyre ose sepse i gjykuan gabim rreziqet e lëshimeve të vogla.

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



Shpresa Programme

Inspiring hope & change

VOLUNTEERS NEEDED!

WE NEED YOUR HELP!

Are you passionate about making a difference in people's lives? Do you want to help individuals facing challenges such as housing issues, welfare benefits, debt, immigration, and more?

We are looking for dedicated volunteers to join our Advice & Advocacy Team. This is a fantastic opportunity to gain hands-on experience, receive specialist training, and help increase our capacity to support vulnerable clients.

Contact us!

020 7511 1586
SHPRESAPROGRAMME@YAHOO.CO.UK
SHPRESAPROGRAMME.ORG

ANDI BUSHATI

CEREMONIA PËR BALLUKUN, PSIKOZA E NDERIMIT TË HAJDUTËVE

Ceremonia e daljes nga skena të Belinda Ballukut ishte organizuar në harmoni të plotë me qëndrimet që Edi Rama dhe PS-ja kanë mbajtur gjatë gjithë kohës, që prej kur ajo u shpall e pandehur: Së pari me një respekt dhe vërim për zyrtaren që ka vënë në zbatim skemën më përbindshme të manipulimit të garave publike në Shqipëri. Së dyti, me një përbuzje dhe injorim të plotë të sentimenteve të publikut, të llahtaritur nga ato që ka dëgjuar e lexuar në bisedat e rrjedhura nga prokurorët.

Si rrallëkujt asaj i kishin mbledhur të gjithë ministrinë për ta duartrokitur në këtë sfilim të fundit. Punonjësit e administratës, mes të cilave disa gra të përbotura dhe burra që kishin veshur maska pikëllimi, dukeshin në sintoni të plotë me fjalët e kryeministrit disa ditë më parë, që i quajti rezultatet e saj “të jashtëzakonshme”. Edhe pasardhësi i ri, në krye të ministrisë, u tregua entuziast nga fakti që ai po prezantohet para stafit prej asaj që ai vijoi ta quante zv/kryeministër, duke mos harruar të shtonte se do çonte përpara me nder stafetën e Belës.

Po të parashutohej në atë sallë dikush që nuk e ka parë e dëgjuar se çka ndodhur 100 ditët e fundit në Shqipëri, ai me siguri do kujtonte se ajo grua që po largohej do ti kishte shpëtuar bashkëatdhetarëve të saj 50 milionë euro tek tuneli i Llogarasë dhe nuk do kishte lejuar zhvillimin e nja nëntë tenderave të manipuluar të unazës.

Kjo ishte atmosfera e ditës së fundit të punës për zv/kryeministren.

Nga ana e saj, në ato pothuajse 20 minuta që foli ajo nuk tha asgjë. Pohoi me ironi se nuk ka treqind apartamente, as jahte apo avionë privatë (gjëra që nuk i përmenden në akuzën e SPAK), por vijoi me kokfortësi vijëslljen për të mos dhënë asnjë argument për ato që akuzohet.

Gjatë tre muajve, që kur u shpall e pandehur, Belinda Balluku, ka bërë gjithsej dy dalje të rëndësishme publike. Së pari, një fjalë para parlamentit, pasi SPAK nxori përgjimet për të cilat akuzohej dhe së dyti tani, kur i tha lamtumirë stafit.

Njësoj si atë 21 nëntor të vitit që shkoi ajo predikoi se e mbështet reformën e



drejtësisë, të nisur nga Rama dhe PS, tha se nuk do të kritikonte apo ofendonte kurrë prokurorët e gjykatësit edhe kur vendimet e tyre kishin kosto personale, gjeti kohë të merret edhe me dy standartet e opozitës kundrejt SPAK-ut. Por, thelbi i dy fjalimeve të Ballukut ishte: “Nuk do komentoj çështje që janë në hetim nga drejtësia”.

Dhe vërtet, po të bësh një bilanc që prej fundit të vitit që shkoi, kur shpërtheu ky skandal, as vetë e interesuara, as kolegët e saj deputetë socialistë, as kryeministri, nuk ka bërë qoftë edhe asnjë koment të vetëm për esencën e akuzave të prokurorëve.

Ata janë marrë me “grushtin e shtetit”, rëmbimin e kompetencave të qeverisë nga gjyqësori, hedhjen në kushtetuese të pezullimit, interpretimin e imunitetit të një deputeti apo ministri, por kurrë me përmbajtjen e bisedave që u gjetën në aplikacionin Signal të ish drejtorit të rrugëve Evis

Berberi, ku tregohet se si manipulohej çdo tender i infrastrukturës, disa herë me urdhër direkt nga Edi Rama.

Në këtë kuptim, rasti Balluku ka thyer një rekord. Nëse për të gjithë dosjet e SPAK edhe Berisha edhe Ahmetaj edhe Meta edhe Veliaj i janë përgjigjur pothuajse një për një, fakteve për të cilat akuzohen, Belinda është struktur pas alibisë “nuk flas për çështje në hetim”.

Mirë apo keq, herë duke thënë të vërtetën, apo herë duke manipuluar, ata të parët kanë zbatuar një parim që duhet ta ndjekë çdo i votuar me zgjedhësit e vet.

Ai ka obligim transparencën, llogaridhënien dhe ndaj akuzave të kundërshtarëve apo medias, e jo më ndaj atyre zyrtare të prokurorisë.

Me mënyrën sesi Belinda Balluku u soll këto tre muaj me çështjen e saj, me strategjinë që ndoqi Rama dhe PS-

ja për këtë rast, u tregua hapur injorimi që ata i bëjnë opinionit publik. Deviza e tyre e re është: nuk denjojmë t’u sqarojmë as kur dyshohemi si hajdutë.

Ky ndryshim sjellje i kësaj kaste të korruptuarish u farkëtua dalëngadalë që kur Balluku nuk u dorëhoq, pastaj duke i kamufluar bisedat e saj banale me Visin si një konflikt që vinte në pikpyetje rendin kushtetues dhe së fundi me refuzimin për ta dorëzuar atë përpara drejtësisë, duke i hequr imunitetin.

Deri diku, kjo lloj mbrojtjeje, mospranimi për të hyrë në detajet e dhënies së tenderave dhe në procedurat që kanë përcaktuar përfituesit e miliona eurove, mund të duket një lëvizje nga halli, si një paranojë e Edi Ramës se mos diskutimet konkretet që do të pasoheshin nga lëshimi i ish zëvendësës, mund të hapte derën hetimit për atë vetë.

Por, taktika se si u zgjodh të bëhej kjo mbrojtje, përbën në vetvete një problem të madh. Sepse duke iu fshehur sqarimit të akuzave, duke anashkaluar dhënien e llogarisë duke përbuzur transparencën, një pushtet jo vetëm tregon arrogancë, por mbi të gjitha ai dëshmon se është prekur nga një sëmundje më e rëndë.

Anashkallimi i këtyre standarteve prodhon automatikisht relativizimin e së keqes, shuarjen e kufirit mes të moralshmes dhe asaj që është e pamundur, deri në atë pikë sa vjedhja mund të paraqitet si virtut. Pikërisht kjo ulëriste me gjithë shëmtinë e saj, mes lotëve dhe fjalëve të atyre që përcollën Ballukun.

Ajo ceremoni kërkonte të impononte si vlerë dikë për të cilin shumica e publikut mendon krejt tjetër gjë.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Dotech

websites 

UPGRADE YOUR WEBSITE

100%
Trusted

I jepni biznesit tuaj një faqe moderne, të shpejtë dhe të lehtë për t'u përdorur, e cila i shndërron vizitorët në klientë. Ne e ridizenjojmë, optimizojmë dhe përmirësojmë faqen tuaj për të rritur performancën, dukshmërinë dhe ndikimin.

Our Services

- ✓ Custom web design
- ✓ E-commerce setup
- ✓ Mobile optimization
- ✓ Website maintenance
- ✓ SEO structure

Build a website that works beautifully fast and converts visitors into customers.

NA KONTAKTONI

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**ITALIAN
RESTAURANT
& PIZZA
PËR SHITJE**

- Klientelë e rregullt
 - Ne qendër të Littlehampton
 - 10 vite Lease
 - Bashkë me restorantin janë perfshirë 4 bedroom flat (kati 2)
- Tel:
07490908230**



ARMAND SHKULLAKU

Partizans e pavarësisë së SPAK me mbështetje amerikane, e panë se kjo ishte një shaka përballë pushtetit të Edi Ramës. Spakistët që menduan të nxjerrin një herë këmbën nga rrethi, në vend të Belës morën bishtin e tyre për ta futur ndër shalë

Duhej të kalonte një dekadë që, më në fund, edhe mbështetësit më të flaktë të reformës në drejtësi të bindeshin, me fjalë e me vepra, se krijesa e lartësuar si ngjizje nga fara e përzgjedhur ndërkombëtare, është një pjellë krejtësisht në duart e Edi Ramës. Ky i fundit u ka treguar sot, si baballarëve të pretenduar ashtu edhe fanatikëve të SPAK (si krijesë e amerikanëve), se babai i vetëm dhe i gjithëpushtetshëm është vetëm ai.

Vendimi i Ramës për t'i prerë SPAK këmbën që guxoi të nxjerrë nga rrethi, duke refuzuar imunitetin e Ballukut, shërben si akti i fundit për t'i vënë kapak një debati që zuri fill sapo u krijuan institucionet e para të së ashtuquajturës drejtësi e re.

Në këtë debat, për përkrahësit e reformës, dy tezaz kryesore të thjeshtuara ishin, e para, se SPAK ishte i pavarur dhe nuk mund të kontrollohej nga Edi Rama përse kohë ishte një investim i SHBA dhe BE dhe, e dyta, se në rast se SPAK do t'i afrohej kryeministrit

SPAK, FUNDI I "BASTARDËVE" PA LAVDI



ky do të ishte i pafuqishëm ta ndalte atë, sepse përsëri bëhej fjalë për një krijesë me fuqi të injektuar nga partnerët strategjikë.

Kryeministri i dha fund sot këtij debati, duke zyrtarizuar me "akt noterial" plotfuqishmërinë e tij mbi pushtetin e drejtësisë. Pretendimet se çdo kërkesë e SPAK nuk do të refuzohet nga mazhoranca, se kjo prokurori është arritja më e madhe në historinë e drejtësisë shqiptare apo se fuqia e Uashingtonit, Brukselit apo Berlinit garanton veprimtarinë e saj, u shkrinë sapo kjo fuqi tentoi të sfi-donte atë që ka nën kontroll të gjitha

pushtetet në Shqipëri. SPAK mund ta pretendojë atësinë përtej kufijve, por Rama u kujtoi të gjithëve se kush e çon ndërmend të rebelohet ndaj tij, përfundon si "bastard" pa lavdi

Në këtë pikë, akti i hapur i Ramës është i vlefshëm për të kuptuar që në zanafillë se pavarësia e SPAK nuk buronte nga investimi amerikan e evropian, por nga vullneti i atij që ka në duar të gjitha pushtetet në Shqipëri. Përse kohë "heronjtë e fëmijëve tanë" i përgjigjeshin thirrjeve të tij për të linçuar dhe burgosur kundërshtarët politikë, përse kohë që merrnin leje për të goditur edhe brenda gardhit të

Rilindjes (për veshmbathje e shtëpi banimi) por nuk guxonin të preknin procedura tenderimesh, ata ishin fytyra e drejtësisë së pavarur. Përse kohë nuk hetohej si u shpikën inceneratorët, check up-ët, 5D-ët..., si vidhet Shqipëria për të vjedhur vota e si vidhen vota për të vjedhur Shqipërinë, SPAK ishte i lirë të vepronte dhe Partia Socialiste nuk bëhej zyrë avokatie për askënd. Kaq mjaftonte që brohorimat për drejtësinë i investuar nga amerikanët të mbysin çdo farë dyshimi se në fakt ajo ishte drejtësia e Edi Ramës.

Në gjysëm provën e parë që SPAK guxoi të ndërmarrë për të hetuar numrin dy të qeverisë, për procedura tenderimesh dhe jo për shtëpi e veshmbathje, pra për thelbin e qeverisjes dhe jo për kumbulla e dardha, Edi Rama doli hapur, me zë, figurë dhe vullë, se drejtësia e re është e pavarur vetëm në territorin që i ka përcaktuar ai.

Dhe nuk ka asnjë forcë, të brendshme apo të jashtme, që mund t'i ndryshojë këta kufij. Partizanët e pavarësisë së SPAK me mbështetje amerikane, e panë se kjo ishte një shaka përballë pushtetit të Edi Ramës. Spakistët që menduan të nxjerrin një herë këmbën nga rrethi, në vend të Belës morën

bishtin e tyre për ta futur ndër shalë

Vendimi i Ramës për t'i rivizatuar botërisht territoret se ku duhet të shkelin pushtetet e tjera, nuk ishte një tërheqje veshi vetëm për SPAK.

Duke refuzuar arrestin për Ballukun, ai eliminoi edhe pushtetin gjyqësor që me siguresat që medemek i ka dhënë sistemi do të mund ta ndryshonte ose jo këtë masë në tri shkallët e gjykimit.

Me këtë akt ai ka dashur të tregojë qartë jo vetëm se në Shqipëri nuk mund të ketë pushtete jashtë kontrollit të tij, por se edhe jashtë Shqipërisë, ata që reformën në drejtësi e cilësonin një histori suksesi, duhet të pranojnë se suksesin e saj e përcakton vetëm Edi Rama.

Me pushtetin që ka akumuluar ai ndihet aq i fortë, sa edhe të ashtuquajturit sponsorë të reformës në drejtësi, nuk kanë se çfarë t'i bëjnë. Brukseli e Uashingtoni ose duhet të pranojnë që pjella e tyre rezultoi një "bastard" në duart e Ramës, ose të vazhdojnë përrallën e reformës si histori suksesi duke mbështetur hetimin e SPAK sipas vijave të përcaktuara nga ai që realisht e kontrollon drejtësinë në Shqipëri


ANDI MUSTAJ

Qasja që një përfaqësues politik ka ndaj kauzave të ndryshme është një tregues i fortë i karakterit të tij, i vlerave që kërkon të rrezatojë dhe, si pasojë, i mënyrës se si do të gjykohej nga qytetarët.

Kur një përfaqësues politik zhvillon ide, ai zhvillon veten e vet, ndërsa kauzat që përfaqëson e detyrojnë atë të shkojë përtej vetes. Edhe pasojat e dështimit janë ndryshe, sepse kur një kauzë që ai mbron dështon, ai mbetet përfaqësues politik, ndërkohë që personat brenda kauzës mund të humbasin çdo gjë. Dhe përtej tyre, si efekt domino, edhe qytetarët e tjerë që ndjekin zhvillimin e ngjarjeve përfundojnë duke gjykuar, duke prodhuar efekte negative të shumta për përfaqësuesin politik.

Politika, për nga vendi që zë në shoqëri, zmadhon kauzat e ndryshme. Duke i bërë publike, duke i mbrojtur përpara institucioneve, duke vënë pra në shërbim të saj aftësinë apo pozicionin e vet, përfaqësuesi politik e zmadhon kauzën duke rritur mundësinë e suksesit të saj. Mbrojtja e kauzave kërkon që ato të zgjidhen me kujdes, sepse në bazë të profilit të vet, një përfaqësues politik nuk do të ketë njëllë besueshmërinë në mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, për shkak edhe të kohës së kufizuar, ai nuk mund të mbrojë shumë kauza njëkohësisht. Kjo nuk do të thotë që të tjerat nuk janë të rëndësishme, por do të thotë që për mbrojtjen e tyre

RADIKALITETI SI SHPRESA E VETME E NJË SHOQËRIE TË RRASKAPITUR



duhet të mbështetet tek anëtarët e tjerë të partisë që një spektër sa më i madh të mbulohej.

Mbrojtja e kauzave kërkon përqafimin e tyre nga përfaqësuesi, sepse vetëm nëse ai beson në to mund të bëhet i besueshëm për publikun. Kjo besueshmëri është themelore që më pas ajo të përvetësohet nga masa. Vetëm përvetësimi i kauzave, pra krijimi i bindjes së brendshme tek një numër i madh qytetarësh se veprimet e tyre bëhen sepse ata besojnë në to dhe jo sepse janë të detyruar, mund të sjellë suksesin e tyre.

Mbrojtja e kauzave kërkon vendosjen e një strategjie të qartë, me qëllime të identifikueshëm dhe të identifikuar rreth të cilëve angazhimi i përfaqësue-

sit politik të jetë radikal.

Në këtë pikë të fundit ndoshta, kemi çaluar më shumë ndër vite. Shumë shpesh kemi parë dështime protestash dhe braktisje kauzash, praktikë kjo e filluar në kohën e Lulzim Bashës, por e shpërndarë si sëmundje në aspekte të ndryshme deri më sot. Çfarë do të thotë kjo për ne apo për vendin? Në dhjetor të vitit 1990, Azem Hajdari i pati thënë babait tim: "I kam hyrë kësaj rruge për të vdekur, jo për ta lënë në mes". Çfarë pasqyre therëse e mediokritetit tonë, zile shurdhuese e pandalshme në veshët e një brezi të përlulur përpara paraardhësve të tij të nderuar.

Çfarë jemi gati të sakrifikojmë për të mbrojtur vlerat tona? Nëse ne, që pretendojmë të përfaqësojmë Partinë

Demokratike në cilëndo hallkë të saj, nuk i përgjigjemi kësaj pyetjeje me fjalët "çdo gjë", atëherë nuk jemi asgjë më shumë se mashtrues që gënjejnë veten dhe popullin prej vitesh, duke pretenduar se po luftojmë një regjim autokratik, ndërkohë që në fakt po luftojmë mullinjët e erës. Duhet të jemi gati të humbasim çdo gjë, sepse bashkëqytetarët tanë po humbasin gjithmonë e më shumë çdo gjë. Të pafuqishëm, ata po zhbëhen brenda botës imagjinare propagandistike të Rilindjes.

Politikisht dhe filozofikisht, radikaliteti shfaqet nëpërmjet mendimeve dhe veprimeve të prera, të cilat synojnë ndryshimin rrënjësor të shoqërisë. Kjo arrihet nëpërmjet një sjelljeje shembullore dhe një gatishmërie për t'i shkuar deri në fund betejave të nisura. Në këtë mënyrë, fitoret e vogla bëhen ortek i një partie me frymë të re.

Kur ne mbrojmë kauza dhe dështojmë në suksesin e tyre apo i braktisim gjatë rrugës, ushqejmë propagandën duke u treguar të dobët dhe njëkohësisht viktima të veprimeve të saj të padrejta. Por në kushtet e sistemit, ashtu siç është ndërtuar, duhet krijuar një mit i kundërt i forcës pozitive që t'i bëjë ballë mitit të forcës negative të regjimit.

Disonanca konjitive e dështimit ose braktisjes së kauzave nuk mbetet në nivel ndjesie individuale. Ajo përket thehet në sjellje kolektive. Kur një

kauzë nis me fjalë të forta dhe përfundon në heshtje, kur një protestë shpallet si betejë ekzistenciale dhe braktiset në ditën e tretë, qytetari e regjistron këtë mospërputhje. Edhe nëse nuk ishte në shesh, ai ndjek ritmin, e ndien intensitetin, e sheh rënien.

Herën e parë zhgënjehet.

Herën e dytë dyshon.

Herën e tretë nuk vjen më.



Kështu krijohet cikli i heshtjes. Jo sepse njerëzit nuk e shohin padrejtësinë. Jo sepse nuk janë të indinjuar. Por sepse nuk besojnë më se beteja do të shkojë deri në fund. Dhe pa këtë besim, askush nuk rrezikon. Askush nuk sakrifikon. Askush nuk del nga zona e sigurisë.

Një kauzë e lënë në mes është më e dëmshme se një kauzë e nisur kurrë. Ajo krijon precedent: dëshmon se fjala mund të zbehet, se premtimi mund të zgjidhet, se përplasja mund të negociohet. Regjimi nuk ka nevojë të fitojë çdo betejë. Në këto kushte i mjafton që të jetë spektator teksa ne vet, shkatërrojmë në mbrëmje atë që kemi ndërtuar gjatë ditës.

Vetëm një qasje radikale mund të thyejë ciklin. Është një qasje në radhë të parë individuale përpara sesa të jetë një funksionim institucional. Beteja që kemi përpara është ekzistenciale, sepse kundërshtari dhe ne bëjmë pjesë në dy botë që nuk mund të bashkëjetojnë.

Coffee & Sandwich for SALE

- * Klientele e rregullt.
- * Garden dhe Lojra për fëmijë
- * Shumë pranë nga qendra e qytetit Brighton.
- * Zonë shumë e populluar me dy shkolla pranë
- * E vetmja kafe në zonë e frekuentuar për shumëllojshmëri ushqimi ,cakes & ice cream.
- * Per informacion të detajuar kontaktoni në
Tel: 07490908230



24 mars 1999.

78 DITË BOMBARDIME: DETAJET KRYESORE TË FUSHATËS SË NATO-S

Pak pas orës 19:00 në kryeqytetin e Serbisë, Beograd, dëgjohej sirenat e para.

Ato paralajmërojnë fluturimin e aeroplanëve ushtarakë të NATO-s mbi qellin e Serbisë.

Pak para orës 21:00, dëgjohej një shpërthim i fuqishëm në fabrikën e aeroplanëve "Lola Utva", në Pançevë të Serbisë.

Flaka dhe tymi mbulon këtë lokacion në periferi të Beogradit. Ky moment shënon fillimin e një fushate 78-ditore të bombardimit të Jugosllavisë.

Aeroplanë të NATO-s bombarduan në territorin e Serbisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

Si erdhi deri te bombardimi?

Mes dilemash dhe kundërshtimesh nga Kina dhe Rusia, atëbotë sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, më 23 mars 1999, në orën 22:17, urdhëroi një sulm ajror mbi Republikën Federale të Jugosllavisë.

Arsyetimi, në Serbi nuk ka gatishmëri për zgjidhje politike të krizës së Kosovës.

Sulmet ajrore nisën pa aprovimin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Vendimi për bombardim u ndërmor pas refuzimit të asokohe presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, që të zgjidhej politikisht kriza e Kosovës.

Fakte të rëndësishme

Më 1999, në Kosovë llogaritej se ishin rreth 40 mijë trupa ushtarake jugosllave.

Në mars 1999, UNHCR-ja përlogariste rreth 475 mijë kosovarë të zhvendosur pas ofensivës së forcave ushtarake dhe policore serbe.

Ky numër vazhdoi të rritej dhe deri në fund të luftës, rreth një milion kosovarë ishin larguar nga vendi.

Sipas të dhënave të publikuara nga Fondi për të Drejtën Humanitare, gjatë luftës në Kosovë, më 1998-1999, janë vrarë mbi 13.500 persona – 76 për qind e të cilëve besohet se kanë qenë civilë. Për më shumë se 1.600 persona të zhdukur në luftë vazhdon kërkimi.

Çka bombardoi NATO-ja?

Bombardimet kishin tri objektiva kryesore: mbrojtjen ajrore jugosllave, sistemet e komandës dhe kontrollit dhe forcat ushtarake serbe të dislokuara në Kosovë.

Sulmet kryesore



24 mars

Bombardohet fabrika për prodhimin dhe riparimin e aeroplanëve në Pançevë, si dhe bombardohen objekte të tjera me rëndësi ushtarake në Serbi.

25 mars

Bombardohet një lokacion në Rozhajë të Malit të Zi, shumë pranë kufirit me Kosovën.

26 mars

Shkatërrohet depoja e karburantit në Lipovicë të Serbisë. Dëmtohet një pjesë e rrjetit elektrik në Batajnicë.

28 mars

Goditet fabrika 'Sloboda' në Çaçak, një prodhues i madh i pajisjeve elektroshtëpiake në Serbi.

1 prill

Granatat godasin një urë midis Novi Sadit dhe Petrovaradinit në Serbi.

3 prill

NATO-ja godet ndërtesa qeveritare në Beograd.

4 prill

Në Beograd bombardohet selia e Ushtrisë Jugosllave.

Shkatërrohet depoja 'Beopetrol' në Beograd dhe Bogutovc në Kraljevë.

Bombardohet depoja e karburantit në fabrikën e kaldajave në Beograd të Ri.

Sulmohet rafineria e naftës në Pançevë.

Sulmohet aeroporti i Sllatinës afër Prishtinës.

Sulmohet 'NIS Jugopetrol' në Smederevë të Serbisë.

5 prill

Goditet një fabrikë e kaldajave dhe rafineria e naftës në Novi Sad.

Goditen depo tjera të 'Naftagas promet' 10 km larg Somborit.

Sulmohet aeroporti kryesor i Beogradit.

Goditet 'NIS Jugopetrol' në Prishtinë.

Goditet një fabrikë e duhanit në Nish të Serbisë.

Goditet fabrika kimike 'Milan Blagojeviq' në Lluçan të Serbisë.

6 prill

Sulmohet depoja e 'Beopetrol' në fshatin Krushë e Madhe në Rahovec.

Sulmohet fabrika e kimikateve 'Milan Blagojeviq' në Lluçan të Serbisë.

7 prill

Bombardohet depoja e 'Jugopetrol'-it në Sombor të Serbisë.

Bombardohen disa lokacione në Prishtinë dhe në Novi Sad të Serbisë.

8 prill

Sulmet e NATO-s vazhdojnë në Kraljevë, mbi objektet qeveritare në Beograd dhe qytete përreth.

9 prill

Aeroplanët e NATO-s bombardojnë kompaninë 'Zastava Automobili' në Kragujevc të Serbisë, 'NIS Jugopetrol'-in në Smederevë dhe transmetuesit e RTS-it në majën e Goleshit, pranë aeroportit të Prishtinës.

10 prill

Bombardohen aeroportet e Prishtinës, Nishit dhe Kraljevës.

11 prill

Sulmohet kompleksi malor 'Divcibare' afër malit Zlatibor dhe një zonë banimi në Novi Sad.

12 prill

Bombardohen disa lokacione në Kosovë dhe në Serbi, në mesin e tyre një tren, depoja e 'Jugopetrol'-it në Prishtinë, një hotel në Kopaonik të Serbisë. Sulme të tjera në depo naftë në Novisad, Pançevë dhe Kragujevc.

13 prill

Sulme të tjera në depo naftë në

Kosovë dhe Serbi.

14 prill

Goditet gabimisht një kolonë me civilë në Kosovë.

Sulmet vazhdojnë në Prishtinë, kryesisht mbi depo naftë.

15 prill

Sulmohen disa lokacione në Serbi.

16 prill

Sulmohet sërish rafineria e naftës në Pançevë dhe ajo në Novi Sad.

18 prill

Sulmohen disa lokacione në Pançevë të Serbisë, por edhe të tjera në afërsi të aeroportit të Sllatinës në Kosovë.

19 prill

Sulmohet një lokacion në Suboticë dhe fabrika e kimikateve në Bariç të Serbisë.

Shkatërrohet transmetuesi i komunikimeve afër Prishtinës.

20 prill

Sulmohen minierat e thëngjillit në Bardh në afërsi të aeroportit të Sllatinës, në periferi të Prishtinës.

Bombardohen objekte qeveritare në Prishtinë dhe një rafineri e naftës në Novi Sad.

21 prill

Sulmohet selia kryesore e Partisë Socialiste të Serbisë në Beograd të Serbisë.

22 prill

Sulmohet një nga rezidencat e presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq.

Sulme në Prishtinë dhe Novi Sad.

23 prill

Bombardohet Radio Televizioni i Serbisë – RTS, në Beograd. Sulmohet një urë në Novi Sad dhe lokacione të tjera në Serbi.

25 prill

Sulmohet zona industriale në Nish.

26 prill

Bombardime në Sombor, Novi Sad, Nish dhe Kragujevc të Serbisë.

Sërish bombardohet aeroporti i Sllat-

inës në Kosovë.

27 prill

Bombardime të rënda në Beograd dhe Surdulicë në Serbi.

Në Kosovë: bombardime në Sllatinë, Deçan, Pejë, Lipjan.

8 prill

Bombardohet rafineria e naftës në Novi Sad, një transmetues televiziv në majën Frushka Gora, dhe bombardohet një depo naftë në qytetin Pozhegut.

Në Kosovë bombardohet një lokacion në Mitrovicë, Prishtinë dhe miniera në Stantërg.

Një granatë bie gabimisht në Sofje të Bullgarisë.

Bombardohet një pjesë e aeroportit të Gollubovacit, afër Podgoricës në Mal të Zi, si dhe në Bar dhe Bijelo Polje.

30 prill

Bombardohen objekte qeveritare në Beograd.

Bombardohet ura mbi lumin Lim në Murino, Mal të Zi.

1 maj

Gabimisht bombardohet një autobus i Nish Express-it në urën e Lluzhanit, në periferi të Prishtinës.

2 maj

Bombardohet kryesisht rrjeti i energjisë elektrike.

Goditet një autobus në Pejë dhe një depo naftë në Prishtinë dhe Rahovec.

Bombardohet një seli e RTS-it dhe rafineria e naftës në Novi Sad.

5 maj

Bombardohet sërish 'Jugopetrol'-i në Nish.

7 maj

NATO-ja gabimisht bombardon Ambasaden e Kinës në Beograd. Vriten tre gazetarë kinezë.

Sulme të rënda në Nish.

Bombardohet një urë rrugës që çon në Rumani.

8 maj

Sulme intensive në Beograd, kryesisht mbi rrjetin elektrik.

10 maj

Bombardohet fabrika e kimikateve 'Prva Iskra' në Bariç.

13 maj

Bombardohet një lokacion në Korishë



të Prizrenit. NATO-ja thotë se aty ishte një vendkomandë e ushtrisë dhe policisë serbe. Vriten dhe lëndohen shqiptarë lokalë.

14 maj

Bombardohet një kamp refugjatësh në magjistralen Prishtinë – Prizren, afër fshatit Korishë.

15 maj

Bombardohen depot e 'Jugopetrol' -it në Bor dhe Beograd.

17 maj

Bombardohet sërish 'Jugopetrol' -i në Bor.

19 maj

Bombardohet depoja 'Jugopetrol' në Beograd.

20 maj

Sulmet ajrore dëmtojnë rezidencat e ambasadorit të Zvicrës, Spanjës, Suedisë, Norvegjisë, Hungarisë në Beograd.

Dëmtohet edhe Ambasada e Libisë, si dhe objekti i misionit diplomatik të Izraelit.

21 maj

Goditet rrjeti përçues i energjisë elektrik në Nish.

22 maj

Goditet dhe dëmtohet rrjeti elektrik në Beograd dhe pjesë tjera të Jugosllavisë.

23 maj

NATO-ja fillon bombardime intensive të rrjetit elektrik. Shumë qytete mbesin pa rrymë dhe pa ujë.

24 maj

Bombardohet rëndë fabrika 'Millan Bllagojeviq' në Lluçani të Serbisë.

27 maj

Bombardohet depoja e naftës 'Jugopetrol' në Bor.

Sulmohet rrjeti elektrik në Beograd.

30 maj

Bombardime në Beograd, në një urë në Serbinë qendrore dhe sanatoriumi në Surdulicë.

31 maj

Bombardohen transmetuesit në Nish.

10 qershor

NATO-ja ndërpret sulmet ajrore ndaj Jugosllavisë.

OKB-ja miraton rezolutën 1244 që parasheh vendosjen e një administrate ndërkombëtare në Kosovë.

Fillon tërheqja e trupave serbe nga Kosova.

Kundërpërgjigja serbe

Ushtria serbe tentoi t'u kundërpërgjigjej sulmeve ajrore të NATO-s. Sipas dokumenteve, brenda Kosovës u përdorën sistemet individuale me rreze më të gjatë për të qëlluar në aeroplanët e NATO-s në një mënyrë të paparashikueshme.

Armatimi i përdorur për të sulmuar

aeroplanët ishte me rreze të shkurtër, si dhe me sisteme të lëvizshme të mbrojtjes ajrore.

Në një raport të NATO-s thuhet se në vend që të zhvendosnin përpjekjet kundër këtyre sistemeve serbe, komandantët e NATO-s zgjodhën të operonin në lartësi përtej të cilave shumica e sistemeve kundërajrore serbe nuk mund të ishin efektive.

Tentimi i ushtrisë serbe për t'u fshehur

Të përballura me sulme intensive nga ajri, trupat ushtarake serbe mundoheshin që gjatë fushatës së bombardimeve t'i hutonin pilotët e NATO-s.

Ata bënëin kamuflime të ndryshme përfshirë këto si në fotografite në vijim:

Këto metoda kamuflazhi paraqiten në një raport të vitit 2000 të Departamentit amerikan të Mbrojtjes që shpjegon organizimin dhe qëllimin e bombardimit të Jugosllavisë.

"Serbët përdorën gjerësisht kamuflimin për të fshehur objektivat taktike, si automjetet ushtarake, dhe objektet fikse, si urat. Përveç kësaj, serbët përdorën mashtrime... për të krijuar një sërë objektivash false", thuhet në këtë raport.

Efikasiteti i sulmeve

Pas përfundimit të Operacionit të Forcave Aleate, NATO lëshoi një vlerësim paraprak të efektivitetit të sulmit të saj kundër një numri objektivash.

Këto objektiva të shkatërruara ose të dëmtuara dukshëm përfshinin:

11 ura hekurudhore
34 ura autostrade
29 për qind e të gjithë depozitimit të municionit serb
57 për qind e rezervave të naftës
Të gjitha rafineritë jugosllave të naftës
14 poste komanduese
Mbi 100 avionë
Dhjetë fusha ajrore ushtarake
Aeroplanët që garantuan suksesin e NATO-s

Duke pasur shumë shtete anëtare dhe aeroplanë të shumtë në dispozicion, në një raport të NATO-s të vitit 2000 përmenden tri lloje aeroplanësh që kanë luajtur rol kyç në suksesin e bombardimit të Jugosllavisë. Në fushatën ajrore ishin përdorur edhe dronët.

Në vijim janë tri modele që janë përkthyer si kyçe për sukses nga NATO-ja.

Është një aeroplan me një pilot, me shumë role që mund të marrë imazhe fotografike ose radar, si dhe të monitorojë komunikimin e armikut dhe të gjejë burimet e sinjaleve elektronike.

Bombardimet e gabuara

Bombardimet e NATO-s nuk ishin gjithmonë të sakta. Ato shkaktuan viktima edhe në mesin e civilëve, si në territorin e Kosovës, po ashtu edhe në Serbi.

Në vitin 1999, vetë NATO-ja vlerësoi se bombardimet kishin shkaktuar rreth 520 viktima civile.

Në disa raste pilotët e NATO-s sulmuan gabimisht caqe që shkaktuan dhjetëra viktima.

Më 14 prill 1999, një incident i tillë ndodhi në periferi të Prizrenit, kur nga bombardimi i NATO-s u vranë mbi 80 civilë shqiptarë.

Një bombardim tjetër i gabimshëm i një autobusi mbi urën e Lluzhanit në magjistralen Prishtinë – Podujevë, vrau rreth 40 civilë, shumica shqiptarë.

Më 5 prill 1999, dhjetë civilë u vranë gjatë një sulmi në kompleksin ushtarak Aleksinac "Deligrad" në Serbi dhe 30 u plagosën.

Më 12 prill, u bombardua një tren në Ristovac që udhëtonte drejt Beogradit duke lënë të vranë 20 persona.

Më 23 prill, nga sulmi i NATO-s mbi RTS-in në Beograd u vranë 16 civilë.

Në prill, po ashtu, u vranë 11 civilë në Surdulica të Serbisë.

Në Murino të Malit të Zi vriten gjashtë civilë më 30 prill.

Në fillim të majit në Nish të Serbisë vriten 14 civilë.

Këto janë vetëm disa nga incidentet dhe nuk paraqesin të gjitha rastet kur bombardimet e pasakta të NATO-s vranë civilë, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi e Mal të Zi.

Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet u ndërprejnë më 10 qershor 1999, me Marrëveshjen Teknike të Kumanovës, e cila parashihte tërheqjen e të gjitha forcave ushtarake dhe policore serbe nga Kosova.

Marrëveshje u pasua me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kjo Rezolutë, ishte një kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës, në Kosovë vendosej një administratë e Kombeve të Bashkuara – UNMIK, e cila administronte fazën transitorë deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës.

Më 12 qershor 1999 filloi vendosja e rreth 50,000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30,000 ishin nga vendet e NATO-s.

KFOR-i është i pranishëm edhe sot dhe kujdeset për sigurinë e Kosovës.

(Radio Evropa e Lirë)

KRIJO WEBSITIN TËND

MOS RRI ANONIM

Me mijera klientë mund të jenë të intersuar për biznesin tuaj, por mbase nuk e dijnë që ti ekziston...



Për çdo konsultim mund
të vini në zyrat tona

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

Dotech
websites

☎ 020 7018 7929

☎ 078 5997 7545

☎ 073 4066 5946

VETON SURROI

Ahmet Shabo me sarajevasit e vet në Ukrainë, Von Trotta në shembjen e Austrohungarisë dhe dy kamenicas që kthehen prej Jemenit

1. “Nuk mund të flas për atë që ndodhi në Hoqin, në tokën e largët të Rusisë”.

Ahmet Shabo është i mbijetuari i një grupi ushtarësh sarajevës që shkuan të luftonin diku në Lindje. Shokët e tij të luftës - rojtarë, të papunë, teneqexhi, ofiqarë e të tjerë-janë pjesë të ushtrisë otomane që lufton Komonuellthin polako-lituanez.

Hoqini ishte i lagësht, qoftë me lumë, kënetë a shi, dhe Ahmet Shabo e shihte tashmë lagështinë e shiut në të kthyer në Sarajevë vetëm me sytë e atij vendi në bregun lindor të Dnjestrin.

Ahmet Shabo ishte në Ukrainë më 1621, i prirë nga Sulltan Osmani II.

Ushtria osmane u ndal në Hoqin dhe u kthye prapa. Prej atëherë Hoqini ka qenë herë pjesë e Perandorisë Osmane, herë principatës së Moldavisë, herë e Komonuellthit polako-ukrainas, herë e Bashkimit Sovjetik dhe Ukrainës së pavarur. Sot është në jug-perëndim të Ukrainës, prej aty shkojnë ushtarë ukrainas në front dhe vijnë refugjatët nga fronti.

Thotë Ahmet Shabo: “Nuk mund të flas për atë që ndodhi në Hoqin, në tokën e largët të Rusisë. Nuk ia vlen të flitet për vrasjen e tmerrshme, për frikën njerëzore, për mizoritë e njëjës dhe palës tjetër, nuk duhet të kujtohet, as të vajtohet, as të festohet”.

2.

Në bregun perëndimor të Dnjestrin, madje bukur larg tij, diku afër Lvivit, u zhvillua një roman tjetër për një luftë tjetër dhe për një fërkim tjetër mes dy sistemeve të ndryshme civilizuese.

Në marshin “Radetzky”, Joseph Roth përshkruan një fisnik austrohungarez (me prejardhje sllovene) që dërgohet në vendin kufitar W., në Galici, në kufirin lindor të Austrohungarisë, atij që ndan Evropën çfarë e njohim prej Rusisë.

Ky vend, që quhet Brody, e ku është lindur autori Joseph Roth, është pjesa e Ukrainës që sot nuk është përfshirë në luftime.

Apo, ashtu i duket, sepse lufta nuk është vetëm me plumbat, krismat e bombave, artilerisë e dronëve, por edhe rrëfimet, madje në masë të madhe rrëfimet.

Në marshin “Radetzky”, kryepersonazhi përshkruan momentin në të cilin



jetonin atëbotë, para asaj lufte dhe tash, para kësaj lufte, banorët e këtij vendi:

"Ata jetonin në një botë që kishte mbaruar tashmë, megjithëse askush nuk e kishte njoftuar ende vdekjen e saj".

Asokohe vdiste rendi i Perandorisë (Austrohungareze, Otomane), kësaj here rendi i ndërtuar në masë të madhe nga Pax Americana që nga viti 1945.

3.

Jemeni është afër zonës së sotme të luftës në Gjirin Persik.

Ka qenë edhe para njëqind e pesëdhjetë vjetësh.

Asokohe Perandoria osmane ritualisht duhej të merrej me kryengritje të arabëve-dikush i quante fise, dikush popuj e Porta e Madhe rrezik për namën e saj dhe për mbarëvajtjen e Perandorisë - dhe ritualisht Porta mobilizonte ushtarët e vet besnikë balkanikë, në krye me shqiptarët. Në mesin e tyre ishin disa nga Ka-

menica. E kryen shërbimin e vet ushtarak, nuk e di a dy, a tre vjet, nuk i kujtohej tamam as rrëfimet Azem Vllasi, dhe të gëzuar që janë gjallë, që nuk u mungon as sy, as këmbë e dorë, të tërhequr nga malli i vendlindjes dhe një jete përpara që lë pas Arabinë e lëmshin e përhershëm me të, nisen këmbë prapa.

Kalojnë shkretëtira e lumenj, liqene dhe male, pyje të dendura me kafshë të egra dhe rrugë të hapura me cuba e ushtarë të harruar të ushtrive që nuk ekzistonin më.

Kalojnë që të gjitha fshatrat, ku asnjë fjalë e vetme nuk ishte e kuptueshme; kalojnë nëpër që të gjitha shikimet e frikës së banorëve prej atyre, të panjohurve që nuk mund të tregonin se kush ishin.

Kalojnë edhe shikimet e atyre që po e ktheve kokën edhe një herë në atë drejtim, zor që mund ta kthesh kokën prapë kurdoherë tjetër dhe ngado tjetër.

Kalojnë shiun të cilit i gëzohen kur flokët e sytë u ishin mbushur zall dhe

kalojnë borën së cilës nuk i gëzohen as me kujtesën e pashlyeshme të fëmijërisë, sepse opingat tashmë janë duke humbur cipën e fundit të ndërmjetësimit mes shputës e dheut.

E dikur hyjnë në Kosovë, fillimisht me vesh. Dëgjohen më në fund fjalët që kanë kuptim, formë, erë dhe ngjyrë.

Dinë se po afrohen dhe se janë ndonjë një orë a më pak afër fshatit, kur pas të gjitha shkretëtirave, lumenjve, pyjeve me shtazë e rrugëve me cuba, fjalësh të gjuhëve që duhej të ishin të dala të gjitha nga Kulla e Babelit, mbërrin në një përpjetë e ngushtë dhe e lartë, përpjeta e fundit pas së cilës del fshati.

njohin menjëherë dhe ofshajnë sikur të ishte edhe një rrugë si ajo prej Jemenit deri këtu: “Ah, na zuri dreqi, mbërritëm te Brija”; ofshama e fundit para cakat, shenja e pashmangshme se sa i vështirë duket në fund të fundit kalimi prej luftës në paqe.

4.

Paragrafi i plotë i parë i Ahmet Shabos është ky:

“Nuk mund të flas për atë që ndodhi në Hoqin, në tokën e largët të Rusisë. Nuk ia vlen të flitet për vrasjen e tmerrshme, për frikën njerëzore, për mizoritë e njëjës dhe palës tjetër, nuk duhet të kujtohet, as të vajtohet, as të festohet.

më mirë të harrohet, në mënyrë që kujtesa njerëzore për çdo gjë të shëmtuar të vdesë dhe që fëmijët të mos këndojnë këngë për hakmarrje”.

Kjo mbetet në letërsi. Jashtë saj jetojmë në botën kur flitet për Hoqinët e sotëm e të kaluar, flitet për vrasjen e tmerrshme, për frikën njerëzore, për mizoritë e njëjës dhe palës tjetër dhe kujtohet e vajtohet dhe festohet.

Kujtesa njerëzore për çdo gjë të shëmtuar po rilind me çdo ditë lufte dhe fëmijët përgatiten të këndojnë këngët e reja për hakmarrje.

koha

KUR VUÇIÇI IZOLOHET, RAMA GATI T'I DALË NË NDIHMË (MADJE EDHE NË DËM TË KOSOVËS)

ENVER ROBELLI

Në shkrimin e tyre të shkruar bashkë dhe të botuar në gazetën “Frankfurter Allgemeine Zeitung” kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç i përçojnë BE-së mesazhin se janë të gatshëm të pranojnë një anëtarësi të klasit të dytë pasi që nuk besojnë se anëtarësimi i plotë është i mundshëm. Fajin për këtë ia lënë BE-së. Thonë se rajoni ka ndryshuar në mënyrë të paimagjinueshme.

Theksojnë se sa i përket hyrjes në BE, shqiptarët mbesin optimistë, serbët janë skeptikë. E vërtetë – rajoni ka ndryshuar, por jo gjithkund për të mirë. Serbia sot është një shtet autokratik, me liri të kufizuar të mediave, pa drejtësi të pavarur, me korrupsion të madh. Më shumë se kurrë Beogradi po kritikohet nga BE për shkak të regresit në shumë fusha.

Pse serbët janë skeptikë? Për shkak se fushata antiperëndimore e regjimit të Vuçiçit si dhe afërsia me Rusinë dhe me Kinën kanë ndikuar që edhe më shumë të forcohet disponimi kundër BE-së në Serbi. Një pakicë e mbështet hyrjen në BE, shumica ëndërrojnë për një vëllazëri ruso-serbe. Beogradi është shndërruar në qendër të spiunazhit rus. Nga aty koordinohen shumë veprime të agjenturave ruse në rajon dhe më gjerë.

Para disa viteve një takim i opozitës ruse në Beograd është përgjuar nga autoritetet serbe dhe regjistrimet i janë dorëzuar Kremlinit. Kur opozitarët u kthyen në Moskë, ata u arrestuan menjëherë. Shqipëria përballet me shumë vështirësi dhe lëngon nga korrupsioni i qeverisë dhe partisë së Edi Ramës, por shoqëria shqiptare nuk është antiperëndimore. Këtu qëndron dallimi i madh me Serbinë.

Duke ia zgatur dorën një autokrati që lufton për mbijetesë politike – dhe i tillë është Vuçiç – Edi Rama edhe njëherë dëshmoi se në politikën e tij të jashtme ka dy konstante: tregimin e përrallave patriotike sa i përket Kosovës dhe kultivimin e një raporti pafalshëm përqafues ndaj liderit në Beograd.

Shkrimi në “Frankfurter Allgemeine Zeitung” nuk përmban ndonjë risi. Se dëshiron që Shqipëria të hyjë në BE pa të drejta të plota, këtë Edi Rama e ka thënë edhe më herët. Pse duhet ta thotë këtë bashkë me Vuçiçin? Sa herë që autokrati serb ndodhet në vështirësi, Edi Rama është i gatshëm t'i dalë në ndihmë. Kur BE kërkon nga Vuçiç t'i vë sanksione Rusisë për shkak të agresionit ndaj Ukrainës, kryeministri i Shqipërisë i kërkon Brukselit dhe kryeqyteteve të tjera të fuqishme të mos i bëjnë presion Vuçiçit.

Në shtator 2022, pak muaj pasi Rusia nisi luftën për të pushtuar mbarë



Ukrainën, Rama i tha gazetës austriake “Die Presse”: “Ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbajtur kërcënimin potencial larg Ballkanit. Prandaj, nuk duhet të ushtrohet më presion ndaj Serbisë për të vendosur sanksione ndaj Rusisë. Sanksione të tilla nuk janë të mundshme, sepse Serbia nuk mund të mbijetojë pa Rusinë.

Përveç kësaj, qeveria dhe presidenti Aleksandër Vuçiç nuk do t'i mbijetonin dot politikisht sanksioneve kundër Rusisë. Serbia tashmë ka mbajtur një qëndrim. Nuk duhet të harrojmë se Beogradi ka votuar tashmë tri herë kundër Rusisë në OKB. Kjo është një surprizë e madhe. Është gjithashtu një shenjë se ka një vullnet të fortë në Beograd për t'u integruar në BE”.

Ka aq shumë të pavërteta në këtë deklaratë. Serbia mund të mbijetojë pa Rusinë. Serbia nuk mbijeton pa BE-në. Volumi tregtar i Serbisë me BE-në është mbi 60 për qind, me Rusinë nën 5 për qind. Serbia ka votuar në OKB për rezoluta që përkrahin integritetin territorial të Ukrainës, por vota e saj nuk ka qenë antiruse, siç pretendon Rama.

Vota e Serbisë ka qenë e tillë me qëllim të qartë: përkrahim integritetin territorial të Ukrainës dhe presion nga bota që të mbështet integritetin territorial të Serbisë (duke përfshirë Kosovën). E pasaktë është kur Rama thotë “se ka një vullnet të fortë në Beograd për t'u integruar në BE”. Ai vullnet nuk ka ekzistuar më 2022, nuk ekziston as sot.

Serbia ia shiti Rusisë industrinë e naftës vetëm pak muaj pasi Kosova shpalli pavarësinë më 2008. Dhe ia shiti me një çmim shumë të ulët, sipas ekspertëve. Për vetëm 400 milionë euro. Ky pazar nuk u bë për arsye ekonomike, por politike, sepse Rusia që nga atëherë, me veton e saj, bllokoi çdo nismë për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Muajve të fundit situata ka ndryshuar falë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat i kanë bërë presion të madh Serbisë që t'ua marrë rusëve pronësinë mbi NIS-in. Kompania hungareze MOL ka shprehur gatishmëri për të blerë aksionet e rusëve në NIS për mbi 1 miliardë euro. Ndonëse u detyrua t'ua marrë rusëve ndërmarjen e naftës, Vuçiç po mbijeton politikisht.

Për çdo ditë ofendon parlamentarët europianë, parlamenti i kontrolluar prej partisë së tij ka miratuar një ligj që eliminon edhe pjesët e fundit të drejtësisë së pavarur, nëpërmjet një operacioni të gjerë po tenon të fusë nën kontroll edhe mediat e pavarura.

Kryeministri i Shqipërisë do të mund të shkruante një tekst të përbashkët me homologun e tij malazez, sepse është Mali i Zi që ka shumë gjasa të hyjë në BE, jo Serbia. Por ndaj udhëheqësve malazezë Rama sillet me përçmim dhe tallet me ta në forume ndërkombëtare.

Nga mesi i kësaj jave Aleksandar Vuçiç tha: “Nuk më shkon ndërmend të pranoj asnjë lloj njohjeje të

Kosovës. (...) Nuk më shkon ndërmend të bisedoj për Kosovën jo me Marco Rubion, por as me Shën Pjetrin. Kosova është Serbi, ka qenë dhe do të jetë, dhe këtu mbyllet diskutimi”. Në fund të javës Edi Rama ia shtron qilimin e kuq Vuçiçit, shkruan një tekst bashkë me të, e merr përdore dhe tenton ta prezantojë para opinionit europian ai politikan manekin me xhakëtë të kadifenjtë që beson dhe punon për vlera europiane.

Një lobim i tillë për Serbinë është vërtet i pashembullt në historinë e re të Shqipërisë. Që Kosova nuk përmendet fare në tekstin e kryetarit të Serbisë Edi Rama dhe kryeministrit të Shqipërisë Aleksandar Vuçiç nuk është befasi. Shumë shtete të BE-së kanë qëndrim se Serbia duhet ta pranojë Kosovën para hyrjes në BE. A beson edhe kryeministri i Shqipërisë në këtë apo po tenton t'ia hap rrugën Serbisë drejt një anëtarësimi të dorës së dytë, por pa e njohur Kosovën?

Edi Rama vazhdon të ketë një qasje shpërfillëse ndaj Kosovës. Para se BE të vendoste masa të padrejta ndëshkuese ndaj Kosovës (të propozuara nga ndërmjetësi proserb dhe miku i Jeffrey Epstein, Miroslav Lajçak), Edi Rama anuloi mbledhjet e përbashkëta me qeverinë e Kosovës. S'ka ndodhur as në kohën e Enver Hoxhës që Shqipëria të jetë prijëtare në ndëshkimin e Kosovës. Me Edi Ramën ndodhin çmeritje të tilla. Në qershor të vitit 2023 kokë më vete i dorëzoi Gjermanisë dhe Francës një draftstatut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Pa asnjë konsultim me Kosovën. Rama mund të kultivojë vesin e hatërmbetjes për shkak se kryeministri i Kosovës në kohën e aventurave të tij politike deshi të bëjë karrierë politike edhe në Shqipëri, por ajo fazë ka marrë fund, andaj nuk ka asnjë arsye që qasja nënvleftësuese ndaj Kosovës të vazhdojë – me fjalë e me vepra. Për shembull: kur e quan veriun e Kosovës “tokë e askujt” (siç bëri në tetor 2023, pak ditë pas sulmit terrorist të një bande të dirigjuar nga Beogradi).

Më herët ishte aventura e tij me “Ballkanin e Hapur”, një shtirje bashkë me Vuçiçin që nuk prodhoi asgjë, ndonëse Rama deklaronte se “BE, Gjermania, Franca dhe SHBA janë të trishtuara që Kosova nuk është pjesë” e “Ballkanit të Hapur”.

Ky projekt tashmë është varrosur, pasi u kundërshtua edhe nga partitë kosovare që sot janë në opozitë. Askush nuk është i trishtuar, shtetet janë kthyer në kuadrin e “Procesit të Berlinit”, aty ku Kosova trajtohet si shtet dhe përfaqësuesit e saj nënshkruajnë në emër të Republikës së Kosovës.

Artikulli i botuar në “Frankfurter Allgemeine Zeitung” nuk është manifest i dy burrështetasve për anëtarësim në BE, as zotim për reforma, por një elegji e dy hallexhinjve që realisht heqin dorë nga ambicia e madhe (anëtarësimi) për shkak se e dinë që në këtë rrugë ata janë pengesa më e madhe si pasojë e skandaleve të pafundme korruptive.



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas



07774222062



07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

